

RAPORTI

I

VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS

TE AKTIVITETIT:

“UZINE EKZISTUESE E FERRO – KROMIT, ELBASAN”

Subjekti: “Albania Chrome” sh.p.k





Vendndodhja: Balldre, Qarku Elbasan

Pergatiti materialin : “Eko- Studio- Projekt” sh.p.k

Tirane, 2015



PERMBAJTJA

-  Hyrje
-  Baza ligjore
-  Metodika e vleresimit te mjedisit
-  Objektivat dhe qellimi i VNM-se

1. **PERSHKRIMI I AKTIVITETIT**

2. **PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI**

3. **VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS**

4. **MASAT PER ELEMINIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS**

5. **KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME**

HYRJE

Aktiviteti njezozor qe zhvillohet ne çdo aspekt te vetin, perveç dobesive ne menyre te pashmangshme krijon dhe “produkte” qe ne perfundim mund te sjellin probleme per zhvillimin e qendrueshem te mjedisit. Pavaresisht nga vlerat dhe volumet edhe ne Shqiperi keto probleme vrojtohen dhe shoqeria e shteti kane synuar dhe vazhdojne te organizojne dhe orientojne kete proces. Ndotja e mjedisit nenkupton shkarkimet e cdo lloj mbetje nga pjese te materialeve te ndryshme ne uje , toke, ajer e cila shkakton ose mund te shkaktoje probleme mjedisore te perkoheshme ose te perhershme ne balancen ekologjike te tokes. Se bashku me zhvillimin e madh qe eshte bere ne industri te ndryshme ne menyre te ngjashme me te njejten shpejtesi eshte rritur edhe sasia e mbetjeve nga perdorimi i te mirave materiale.

Materiali qe paraqitet trajton ndikimet ne mjedisin fizik dhe human te aktivitetit:

“Uzine ekzistuese e ferro – kromit, Elbasan”

Raporti i *Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis* siguron qe ndikime mjedisore te rendesishme jane vleresuar dhe marre ne konsiderate ne menyre te kenaqshme ne planifikim, projektim dhe zbatim te projektit.

Kur parametrat mjedisore nuk jane konform ligjeve, normave dhe rregullave te mjedisit, rrjedhimisht kemi ndotje te tij dhe prishje te ekuilibrave natyror.

Nxitja e zbatimit te ketyre normave kerkon nje perkujdesje nga ana e organeve legislative dhe vendimmarrese, ne menyre qe te rritet interesi si dhe detyrimi per ruajtjen e ekuilibrave natyror.

Ne kete raport *Vleresimi Ndikimi ne Mjedis* eshte trajtuar aktiviteti:

“Uzine ekzistuese e ferro – kromit, Elbasan “

Raporti i *Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis* eshte nje studim qe synon parashikimin e te gjitha efekteve te pritshme ne mjedis, qe do te rezultojne nga projekti i propozuar, si gjate zbatimit te tij dhe gjate funksionimit.

BAZA LIGJORE

Relacioni u pergatit ne zbatim te akteve ligjore dhe nenligjore Mjedisore :

- *Ligji Nr.10 431, date 09.06.2011 “ Per Mbrojtjen e Mjedisit”*
- *Ligji nr. 10 448 date 14.07.2011 « Per Lejet e Mjedisit »*
- *Ligji nr.10 440 date 07.07.2011 « Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis »*
- *Urdhrin e ministrit nr. 146 dt. 8.5.2007 ”Per miratimin e listes se kuqe te flores dhe faunes”*
- *Udhezimin nr 8 dt. 27.11.2007 “Per nivelin kufi te zhurmave ne mjedise te caktuara”*
- *Ligji nr. 9010 dt. 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”*
- *Ligji nr. 8897 dt. 16.05.2002 “Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja”*
- *Ligji nr. 10 463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”*
- *Vendim nr.805 date 4.12.2003 « Per miratimin e listes se veprimtarive qe ndikojne ne mjedis per te cilat kerkohet leje mjedisore »*
- *Ligj nr. 8094 date 21.03.1996 « Per largimin publik te mbeturinave »*
- *Udhezim nr.1 date 03.03.2009 « Per detyrat e organeve mjedisore per te siguruar pjesemarrjen e publikut dhe te OJF-ve mjedisore ne procesin e vleresimit te ndikimit ne mjedis »*
- *Udhezim nr.3 date 19.11.2009 ‘Per metodologjine e raportit te VNM’*
- *VKM nr.419 date 25.6.2014 « Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjedisi te tipave A,B dhe C per transferimin e lejeve nga nje subjekt te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mejdisit si dhe rregullave te hollesishme per shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKL-ja ».*

1. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

➤ Profili i propozuesit

Subjekti "Albania Chrome" sh.p.k ushtron aktivitetin Uzine Ferro – Kromi, Elbasan.

Pershkrimi i aktivitetit

Lenda e pare:

Prodhimi i Ferro-Kromit me karbon te larte eshte nje proces metalurgjik i cili bazohet ne reduktimin e oksideve te mineralit te kromit (kryesisht Cr₂O₃ dhe Fe₂O₃), ne furrat mineralo-reduktuese me hark elektrik te mbuluar.

Lenda e pare per prodhimin e FeCr, eshte minerali i kromit i cili nxirret nga minierat e kromit (kryesisht ne Bulqize) si dhe nga operatore te tjere private qe kane ne shfrytezim miniera. Per reduktimin e oksideve te mineralit perdoret koks metalurgjik i cili furnizohet nga Bosnja-Hercegovina. Per rregullimin e parametrave te skorjes perdoret kuarci, I cili furnizohet nga rajoni I Pogradecit nga nje furnitor privat. Per te tre lendet e para, ka nje sere karakteristika teknike te cilat ndikojne ne ecurine e procesit si dhe ne treguesit tekniko-ekonomike te prodhimit.

Procesi teknologjik

Linja teknologjike e prodhimit te FeCr nga furnizimi i lendeve te para deri ne pregatitjen e produktit te gatshem per eksport eshte si me poshte: Minerali I kromit furnizohet me kamione, ne garnitura afersisht 1000 t, i cili pasi peshohet depozitohet ne sheshet e depozitimit te mineralit prane objektit te perpunimit te lendeve te para. Pasi plotesohet partia, behet mostrimi i saj dhe pasi del analiza , partia e mineralit futet ne depot e mineralit ne objektin e lendeve te para, pa u perziere me stoqet e tjera te mineralit. Me pas minerali i nenshtrohet procesit te coptimit, per te siguruar granulometrine e nevojshme per t'u perdorur ne furre.

Furniturat e koksit metalurgjik dhe te kuarcit depozitohen drejt e ne objektin e lendeve te para dhe analizohen aty. Koksi dhe kuarci nuk I nenshtrohen asnje perpunimi, pasi ato furnizohen ne granulometrine e kerkuar. Minerali, koksi dhe kuarci ngarkohen ne bunkeret e dozimit, ku nepermjet nje sistemi te automatizuar behet dozimi i lendeve te para sipas receptures se hartuar nga drejtuesi i procesit teknologjik.

Nepermjet nje sistemi transportieresh dhe ngarkuesish, lendet e para te dozuara sipas receptures dhe te perziera me njera tjetren ngarkohen ne furren shkriese mineralo –reduktuese, dhe i nenshtrohen procesit te shkrirjes dhe reduktimit. Furra ne vetevete eshte nje kroxhol metalik, e veshur me material zjarrdurues, ne te cilen behet procesi I shkrirjes nepermjet harkut elektrik te krijuar nga tre elektodat me banjen e materialit. Furrat jane ne cikël te panderprere ngarkimi (ngarkohen vazhdimisht nga siper) dhe pasi materiali I ngarkuar ka kryer procesin e shkrirjes dhe reduktimit shkarkohet periodikisht, nepermjet procesit te derdhjes se saj nga vrima e derdhjes sipas nje cikli afersisht ne cdo tre ore.

Temperatura e shkrirjes se skorjes ne procesin e prodhimit te FeCr shkon 1650-1730°C, ndersa e metalit, eshte rreth 100 grade me e ulet. Skorja dhe metali dalin bashke nga vrima e derdhjes dhe zbrazen ne kovat e derdhjes se metalit (te veshura me material zjarrdurues) dhe kovat e skorjes prej materiali metalik (gize speciale). Ndarja e metalit nga skorja, realizohet ne koven e metalit duke shfrytezuar diferencen ne peshe specifike. Pas derdhjes, kova e metalit pastrohet nga skorja, (nepermjet kullimit te saj) dhe metali derdhet ne poligonet e derdhjes se metalit. Pasi mpiksen dhe ftohen, lingotat e metalit kalojne ne repartin e coptim fraksionimit. Ne repartin e coptimit behet thyerja dhe ndarja ne fraksione (nepermjet nje sistemi thyersish dhe sitash vibruese) dhe sigurohet produkti i gatshem, I cili evadohet ne parti 100-200t, analizohet, depozitohet ne stoqe te vecante sipas perberjes kimike dhe eshte I gatshem per shitje.

2. PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI

Pozita gjeografike

Rrethit Elbasanit ka klime te pershtateshme per kultivimin e te gjitha kulturave, qe nga agrumet e perimet ne ambiente te mbrojtura dhe deri tek arrat e geshtenjat si kultura me nevoja ekstreme. Mesatarisht bien 1170 mm reshje ne vit dhe ka nje temperature mesatare vjetore 15 - 18 ° Celcius, me temperature minimale 0 - 3 grade dhe maksimale 32 - 35 grade. Ka mesatarisht 2530 ore ndriçim diellor ne vit dhe 332 dite me diell. Ka nje lartesi mbi nivelin e detit 70 - 128 metra nga Elbasani deri ne Dumre dhe me e larta 1411 metra maja e malit Bukanik. Mbizoteron klima medhetare kontinentale.

Rrethi Elbasanit ka rezervat me te medha ujore ne vend. Ai pershkohet nga dy lumenj, Shkumbini e Devolli, qe veç perdorimit te tyre per ujitje kane sasi te medha inertesh. Rrethi Elbasanit ka 59 ujembledhes me nje siperfaqe prej 800 hektare. Ne 700 hektare te tyre kultivohet peshku. Nga keto, 39 jane natyrore, kryesisht ne Dumre, duke I dhene kesaj zone nje bukuri te rralle dhe mundesi te medha zhvillimi.

Thellesia e liqeneve natyrale eshte 7 - 10 m me nje thellesi maksimale 61 m. Temperatura e ujit ne thellesi 25 - 50 cm eshte ne dimer 7.5° dhe ne vere 25° Celcius, temperature kjo e pershtatshme per gjallesat nenujore gjate gjithë vitit. Keto liqene me rezerva ujore prej 30 milion metra kub, shtrihen ne nje pllaje prej 280 km katror.

Kushtet klimatike

Kjo zone perfshihet ne zonen klimatike mesdhetare kodrinore juglindore. Ajo karakterizohet nga ndikimi i detit Adriatik. Era gjysme e ngrohte vjen nag veriperendimi kurse ne gjysmen e ftohte te vitit nga juglindja.

Siç dihet, qyteti i Elbasanit ka patur vazhdimisht problem me nivelin e lartë të ndotjes së ajrit, si rezultat i industrive që operojnë atje, ndërkohë që ky ishte grupi i parë i punës që ndërmori këtë monitorim për nivelin e ndotjes, duke verifikuar në detaje përqindjen e sasisë që mbart kjo ndotje. Megjithate, vërehet një ulje graduale e përmbajtjes së grimcave LNP e të imta PM 10, në ajrin e qytetit të Elbasanit, si rezultat i fillimit të vendosjes së filtrave në fabrikën e çimentos ECF dhe në uzinën e shkrirjes së çelikut "Kurum" ipas rajonizimit klimatik objekti ben pjese ne nenzonen mesdhetare malore jug lindore. Temperaturat deri ne 1300 m lartesi lekunden ndermjet 7-10 grade celsius, ne pjeset me te larta 3-6 grade celsius. Temperatura mesatare e janarit eshte -1 deri -2 per pjesen e ulet, dhe -3 deri -4 per pjeset me te larta. Temperatura mesatare e gushtit eshte 25-32 grade celsius.

Flora dhe flora

Kjo zone perfaqsohet kryesisht nga shkurret mesdhetare dhe ai i dushkut. Shkurret me te perhapura jane marja, dellenja, shqopa, shkoza, mënishtja, xina etj. Nje pjese te mire perfasohet nga makja.

Toka

Toka apo solumi ne kuptimin pedologjik cilesohet si masa qe vendoset mbi shkembin rrenjesor te planetit. Ne varesi nga kushtet ne te cilat formohet toka ajo pasqyron cilesi fizike, kimike, biologjike, prodhuese etj. Per te vleresuar cilesit e tokes perdoren teknika te ndryshme por per

disa vleresime si ato morfologjike, strukturale, kapaciteti ujembajtes etj vleresimi behet ne fushe nepermjet studimit te profilit i cili eshte nje prerje vertikale e tokes deri ne shkembin rrenjesor (primar) Mbas hapjes se profilit te tokes studiohen shtresta horizontale qe e perbejne ate dhe qe quhen horizonte tokesore.

Kushtet hidrogeologjike

Ujerrat nentokesore ne Shqiperi jane te pranishem ne shkembinj te ndryshem te koherave te ndryshme nga periudha paleozoike ne ate kuaternare. Eshte nje pasuri natyrore shume e rendesishme sepse eshte burimi kryesor per uje te pijshme. Ujerrat nentokesore u nenshtrohen faktoreve klimatike, morfologjike, hidrologjike dhe gjeografike .

3. VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

Nje nga objektivat eshte edhe identifikimi i ndikimeve te mundshme qe mund te shkaktohen ne mjedis nga ky aktivitet ne teresi. Identifikimi i ndikimeve te mundshme ne mjedisin e kesaj zone do te vleresohen gjate fazes se funksionimit te fabrikes te riciklimit te plastikes dhe prodhimit te ambalazheve plastike. Aktiviteti eshte me karakter riciklues dhe teknologjia qe ai do te perdore garanton ndikime minimale ne mjedis.

- **Ndryshimet ne popullsi**

Aktiviteti i firmes "Albania Chrome" sh.p.k ne perpunimine mineralit te kromit, eshte shume i vogel ne krahasim me popullsinë e rajonit, pasi dhe vete popullsia qe banon ne zonen ku synohet te zhvillohet projekti eshte shume e vogel dhe ne distance te larget nga fabrika. Por duke e pare ne kontekstet e fabrikes se pasurimit te mineralit te kromit mund te themi se aktiviteti ne fjalë do te ketë ndikim pozitiv ne popullsinë e zonës, duke kontribuar drejtpërsëdrejti ne rritjen e mirëqënies së tyre ne përmisimin e infrastrukturës së zonës dhe punësimin e tyre.

- **Nivelet dhe ndikimet e emëtimeve të ardhura nga projekti i zhvillimit gjatë fazës normale të operimit**

Gjatë fazës normale të operimit të projektit nuk do të ketë emetime të gazrave, lëngjeve, mbetjeve toksike, helme të ndryshme dhe substanca të tjera të dëmshme, të cilat mund të ndikojnë negativisht në shëndetin e punonjësve, banorëve dhe mjedisin përreth, duke përfshirë të

gjitha llojet e bimëve dhe gjallesave të ndryshme. Gjatë transportit të mineralit të kromit do të punojnë makinat e transportit, por që nuk kanë ndonjë ndikim në mjedis pasi qëndrimi i tyre në objekt nuk do të jetë për një kohë të gjatë. Mjetet e transportit nuk do të krijojnë ndonjë problem në trafikun e mjeteve pasi dhe numri i tyre do të jetë i vogël.

- **Nivelet dhe ndikimet e zhurmave nga projekti zhvillues**

Zhurma në këtë objekt do të shkaktohen vetëm nga procesi i bluarjes dhe thyerjes së mineralit të kromit, punonjesit do të jenë të pajisur me mjete mbrojtëse për veshet. Zhurmat e tjera do të jenë nga mjetet e ngarkimit dhe atyre të transportit. Zhurmë tjetër do të jetë ajo e mjeteve të transportit, të cilat numri i tyre do të jetë shumë i vogël dhe zhurmat janë të papërfillshme dhe të kontrolluara.

- **Emetimet në ajër**

Emetimet në ajër përfaqësohen nga gazrat që dalin nga motorët e makinave të transportit gjatë transportimit të mineralit të kromit. Duke marrë edhe parasysh që qendrat e banuara janë në një distancë relativisht të largët nga zona ku do të ushtrohet aktiviteti për perpunimin e mineralit të kromit dhe ku do të punojnë këto makina. Emetimet e tjera në ajër përfaqësohen vetëm nga gazrat e materialeve me djegje të brendëshme të kompresorit të makinave të ngarkimit dhe të mjeteve të transportit që do të përdoren në fabrike. Gjithashtu një tjetër ndikim vjen dhe nga emetimet e grimcave të pluhurit si pasojë e thyerjes dhe bluarjes së mineralit të kromit.

- **Flora dhe fauna**

Në zonën ku është instaluar linja teknologjike e Fabrikës së Perpunimit nuk ka ndonjë lloj ose specie flore apo faune që mbrohet me status të vecantë. Flora dhe fauna lokale nuk do të preket nga aktiviteti i fabrikës, mbasi sipërfaqja e objekti është pothuajse e zhveshur nga bimesia.

- **Trajtimi i ujrave**

Teknologjia për pasurimin e mineralit të kromit parashikon përdorimin e ujit për realizimin e proceseve kryesore që zhvillohen në fabrike. Ujrat e teknologjike do të trajtohen me metoda fiziko kimike dhe do të dekantohen duke ruajtur cilësinë e mjedisit ujor prites. Rrjedhja e metejshme e tyre do të bëhet në përputhje me rrjedhjen natyrore të tyre. Ujrat e përdorura do të ripërdoren perseri në procesin për perpunimin e mineralit të kromit.

- **Prodhimi i mbetjeve dhe depozitimi i materialve qe krijohet gjate hapjes dhe shfrytezimit te objektit**

Gjate proceseve qe zhvillohen ne Fabriken e Perpunimit te mineralit te kromit, kemi gjenerimin e nje sasie mbetjesh sterile, skorje, te cilat depozitohen ne vendepozitimin e caktuar nga shoqeria per ruajtjen e metejshme te tyre ne kushte strike, duke mos ndikuar ne cilesine e mjedisit te zones perreth.

- **Ndikimi ne infrastrukturen e zones se objektit**

Fabrika gjate fazes se funksionimit te saj eshte e lidhur me rrugen ekzistues te pershkruar ne projekt. Transporti i materialit nga objekti e perpunimit do te behet me kamione 30 ton duke perdorur rrugen e permendur me siper . Aktiviteti i transporti qe do te kryhet nga subjekti i shfrytezimit deri ne Fabriken e perpunimit nuk e rondon trafikun aktual ne rruge, mbasi numuri i kamionave qe do te kalojne ne te eshte i vogel.

4. MASAT PER ELEMENIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE

Me qellim minimizimin e efekteve negative mjedisore dhe rritjes se efekteve pozitive ne mjedis, nga ana e shoqerise do te sigurohet marrja e masave si me poshte:

- **Cilesia e ajrit**

Per permiresimin e cilesise se ajrit ne ambjentet e punes subjekti “Albania Chrome” sh.p.k do te investoje per mbrojtjen e mjedisit per ndikimet negative. Ne linjen e thyerjes dhe bluarjes se kromit do te instalohen sfrucatore te cilet bejne kapjen e pluhurit. Punetoret do te pajisen me maska me fibra karboni. Per eliminimin e grimcave te pluhurit qe mund te krijohet gjate ngarkimit-shkarkimit dhe transportit te lendes se pare, investitori ka ndertuar nje rrjete te brendshem per sperkatjen e sheshit me uje, kryesisht gjate periudhes Qershor-Shtator ku dhe temperaturat jane me te larta dhe mundesia e perhapjes se pluhurit eshte me e madhe.

- **Zhurmat**

Per eliminimin e zhurmave shoqeria ka investuar ne nje sere masash e paisjesh. Punonjesit jane te paisur me tapa veshesh per te shmangur nivelin e larte te zhurmave ne organet shqisore dhe jane te paisur me veshje te tille per tu mbrojtur njekohesisht edhe nga pluhurat demtimet e syve, vesheve, etj. Nepermjet maskave te posatshme.

- **Rastet aksidentale**

Do merren masat per parandalimin e tyre, pajisjet ne fabrike do kontrollohen vazhdimisht per gjendjen teknike te tyre. Shoqeria siguron se do kete nderhyrje te menjehershme nese do te kete ndikime negative ne mjedis.

- **Kushtet e punes**

Persa i perket sigurimit teknik te punonjesve ata do jene te mire informuar mbi rregullat e sigurimit teknik gjate kryerjes se punes, konform rregulloreve perkatese per mbrojtjen e jetes dhe shendetit. Gjithashtu shoqeria do i pajis me uniforma dhe mjete mbrojtese.

- **Vleresimi i efektivitetit te pritshem te masave zbutese**

Realizimi i objektivave dhe treguesve te pritshem te parashikuar do te varet nga respektimi i te gjithë treguesve te percaktuar. Kontrolli dhe permiresimi i vazhdueshem i kushteve te punes ne shoqeri do te çojne perfundimisht ne nje proces pune te kontrolluar me shkarkime brenda normave, duke mos sjelle pasoja per shendetin e njerezve dhe mjedisin perreth. Nuk ka shkurre te gjata perreth.

KONKLUZIONE

- ✓ Niveli i zhurmave të ciluara gjatë ushtrimit të aktivitetit është në përputhje me vlerat kufi të percaktuara në legjislacionin mjedisor në fuqi.
- ✓ Shoqëria ka ndërtuar rrjetin e kanalizimeve të ujërave sipërfaqesore, të cilat para se të shkarkohen kalojnë në bazenin dekantues, ku depozitohen lëndet e ngurta.
- ✓ Për një punë sa më optimale në ambientet e ushtrimit të aktivitetit zbatohen rregullat e sigurimit teknik dhe puntoret e manovratorit njihen me këto rregulla në mënyrë periodike nga drejtuesit teknik të firmës.
- ✓ Në uzinen e ferrokromit të subjektit “**Albania Chrome**” Sh.p.k punonjësit janë në profesionet e teknologut, shoferit dhe punëtorit të thjeshtë. Për të krijuar një ambient punë optimal dhe sa më konfort, subjekti “**Albania Chrome**” Sh.p.k ka pajisur të gjithë punonjësit që punojnë në prodhim me uniformë, kapele dhe me mjete mbrojtëse ndaj pluhurit dhe faktorëve të tjerë

REKOMANDIME

- Të kontrollohen, pastrohen dhe mirembahen kanalet kulluese në territor.
- Të vazhdohet gjelbërimi i mjedisit duke e rritur numrin e pemëve të mbjella.
- Të njihen punonjësit periodikisht me rregullat e sigurimit teknik, si dhe me efektet pluhurave, zhurmave, duke marrë masat e duhura për zbatimin e kartës teknologjike të paisjeve dhe shmangien e avarive gjatë procesit të punës.
- Të largohen të gjitha mbetjet ngurta që krijohen si rezultat i punës dhe aktivitetit njëzëror në vendet e percaktuara nga pushteti lokal.

Per “EKO - STUDIO - PROJEKT” sh.p.k

Ing. Xhevair DERMYSHI

MSc. Ing. Majola QATJA